FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Raporti i garës seleksionuese për Salamunov Memorial 2025

Data: 08 Mars 2025
Vendi: Pallati i Rinisë dhe Sporteve, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës e Kosovës
Qëllimi: Përzgjedhja e gjimnasteve për garën ndërkombëtare "Šalamunov Memorial 2025"

Përshkrimi i garës

Në bazë të kompetencave të selektoreve të kombëtares së Kosovës në gjimnastikë, dhe duke u bazuar në direktivat e garës "Salamunov Memorial 2025", Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka organizuar një garë kontrolluese për përzgjedhjen e gjimnasteve të grupmoshës children (të lindura më 2015 ose më të reja). Gara u mbajt më 08 mars 2025 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve.

Klubet janë njoftuar për këtë garë më 2 mars, me udhëzime të detajuara për kriteret teknike të përzgjedhjes, bazuar në Kodin e Poentimit me disa modifikime për fëmijë.

Pjesëmarrja dhe kriteret teknike

Në garë morën pjesë gjimnaste nga dy klube: Klubi i Gjimnastikës Omnisport dhe Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova. Të gjitha gjimnastet e paraqitura kishin të plotësuar kriterin e grupmoshës. Gara u zhvillua në katër disiplina dhe kishte për qëllim vlerësimin e nivelit të gjimnasteve, përgatitjes fizike dhe ekzekutimit të elementeve në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
Kapërcime: Lartësia 115–125 cm; lejoheshin dy pedane.
Paralele: Minimum 5 elemente + dalje; element i detyrueshëm bar kip, pa ndalesa.
Tra ekuilibri: Minimum 7 elemente + dalje; kërkoheshin 4 elemente akrobatike, lidhje vallëzimi dhe piruete.
Parter: Minimum 7 elemente; përfshirë salto para/prapa, salto 360° dhe pas vallëzimi.

Vlerësimi dhe përzgjedhja

Gara filloj në ora 11:00.
Gjyqtaria dhe vlerësimi u kryen nga selektoret: Doruntinë Ibrahimi dhe Abeliana Bregu.

Secila gjimnaste u vlerësua në bazë të një liste kontrolluese.
Pas analizimit të performancës dhe përmbushjes së kërkesave, u konstatua se:
Hira Elshani, e lindur më 2015 (Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova), i plotëson më së afërmi të gjitha kriteret për përfaqësim ndërkombëtar në kategorinë e fëmijëve.
Gjimnastet tjera pjesëmarrëse në seleksionim, nuk ishin ende në nivelin e duhur për përfaqësim ndërkombëtar.

Përfundim
Si rezultat i kësaj gare kontrolluese, Hira Elshani është përzgjedhur të përfaqësojë Kosovën në garën zyrtare "Salamunov Memorial 2025", duke iu bashkuar ekipit kombëtar të formuar më parë për këtë gare.

Foto nga Gara:





	

Amir Tahiraga _____

Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së

FGJK – KGF

Shtëpia e Sporteve, Rr: "Agim Ramadani" 10000 Prishtine, tel: +38344145009, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com